



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 155 prot.

Kamëz, më 24.10.2022

V E N D I M
Nr. 133. Datë 24/10/2022
M B I

“NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 65 DATË 25.06.2020 MBI NGRITJEN E KOMISIONIT TË STREHIMIT DHE RREGULLOREN E FUNKSIONIMIT TË TIJ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.10.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.116 Datë 24.10.2022 në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisen vendore" i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1, nenpika 1.1, shkronja "b", neni 54 shkronja "k", neni 55 pikat 2 dhe 6; Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 113; Ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" neni 2, pika 51 dhe nenit 15, pika 5, me qëllim respektimin e procedurës së përzgjedhjes së përfituesve të programeve të strehimit si dhe vlerësimin e tyre dhe kriterëve të pranimit të tyre; **Këshilli Bashkiak Kamëz”;**

V E N D O S I:

1. Miratimin mbi ndryshimin e vendimit nr.65 Datë 25.06.2020 për një ndryshim në përbërjen e Komisionit të Strehimit dhe Rregulloren e organizim funksionimit të Komisionit të Strehimit.

2. Komisioni i Strehimit të ketë përberjen si më poshtë vijon:

- Kryetar Drejtori i Drejtorisë Emergjencave Civile dhe Strehimit
- Anëtar Drejtori i Ndhmës Ekonomike dhe Çështjeve Sociale
- Anëtar Drejtori Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit
- Anëtar Përgjegjës i sektorit Ligjor pranë Drejtorisë së Çështjeve Ligjore
- Anëtar Përfaqesues nga organizata Eorld Vision

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të krijojë rregulla për përberjen dhe funksionimin e Komisionit të Strehimit në mënyrë që të sigurohet një veprimtari sa më transparente dhe efiçente, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në baze të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, nenit 2 pika 51 dhe nenit 15 pika 5. të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" dhe aktet nënligjore për zbatim të tij.

Neni 3
Parimet

Komisioni i Strehimit në veprimtarinë e tij respekton parimet e parashikuara në nenin 3 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social".

Komisioni kryen procesin e vlerësimit të dokumentacionit duke respektuar parimin e ligjshmërisë, parimin e proporcionalitetit, barazisë, paanshmërisë dhe efektivitetit.

Neni 4
Përbërja dhe funksioni ligjor i Komisionit të Strehimit

Komisioni i Strehimit shqyrton dhe merr vendime në lidhje me kërkesat e paraqitura nga çdo subjekt që kërkon për të përfituar nga njëri prej programeve sociale të strehimit, si dhe për çdo çështje tjetër që parashikohet nga legjislacioni për strehimin, çështjet sociale apo nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore që përcaktojnë shqyrtimin e kërkesave nga ky komision.

Komisioni i Strehimit do të përbëhet nga 5 anëtarë me të drejta të plota, ku 4 anëtarë janë nga drejtoritë përkatëse të Bashkisë Kamëz dhe 1 përfaqësues të komuniteteve të interesuara të cilat krvejne aktivitetet brenda qytetit të Kamzës dhe janë të regjistruar sipas kriterëve që përcaktohen në ligj (psh OJF).

Drejtori i Drejtorisë Emergjencave Civile dhe Strehimit do të jetë në cilësinë e Kryetarit të komisionit dhe të tjerët në cilësinë e anëtarëve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Neni 5

Kompetencat e Kryetarit të Komisionit të Strehimit

Drejton mbledhjen e Komisionit të Strehimit dhe diskutimet si dhe siguron zbatimin e ligjit në marrjen e vendimeve të Komisionit. Në rast se Kryetari mungon ai i delegon detyrën njërit prej anëtarëve të autorizuar prej tij.

Cakton datën, vendin dhe orën e mbledhjes së Komisionit të Strehimit. Mbledhjet i njoftohen antarëve 5 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes duke i shpërndarë secilit anëtar rendin e ditës.

Neni 6

Kompetencat e Sekretarit Administrativ

Komisioni i Strehimit asistohet nga një sekretariat administrativ, i cili asiston komisionin gjate gjithë veprimtarisë së tij.

Anëtarët e sekretariatit janë pjesë e Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit përkatësisht:

1. Drejtori i Drejtorisë Emergjencave Civile dhe Strehimit
2. Sektori i strehimit

Sekretariati administrativ është përgjegjës për:

- a. Marrjen në dorëzim të aplikimeve dhe kërkesave që janë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së Komisionit;
- b. Shpërndan dhe vë në dispozicion të anëtarëve, materialet për mbledhjen e radhës, brenda 5 ditëve pune para datës së mbledhjes;
- c. Njofton kryetarin e komisionit për çdo kërkesë të paraqitur për shqyrtim dhe u njofton anëtarëve datën e marrjes në shqyrtim të kërkesës së aplikantit;
- d. Dhënie e mendimit kur i kërkohet nga komisioni, mendin i cili pasqyrohet në procesverbalin e mbledhjes;
- e. Mban, harton dhe nënshkruan procesverbalin e mbledhjes;
- f. Zbardh vendimin e arsyetuar të marrë në mbledhjen e Komisionit;
- g. Ruan konfidencialitetin;
- h. Çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari apo Komisioni i Strehimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCEVE CIVILE DHE STREHIMIT

Neni 7

Thirja e mbledhjeve dhe funksionimi i Komisionit

Komisioni i Strehimit mbledhet një herë në muaj. Në raste emergjente si dhe për çështje të cilat nuk mund të presin mbledhjen e rradhës, me kërkesë të kryetarit ose njërit prej antarëve Komisioni mund të mbledhet jashtë rradhës.

Lajmërimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të tregoj në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet (rendi i ditës).

Anëtarët e Komisionit të cilët janë në kushtet e konfliktit të interesit duhet të ndiekin procedurën sipas ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar.

Komisioni kryesohet nga kryetari dhe merr vendime kur në mbledhje marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve (50%+1). Në raste barazie votash vota e kryetarit mbizotëron.

Komisioni i Strehimit shqyrton dhe vlerëson aplikimet e sakta në bazë të kriterëve për përzgjedhjen e përfituesve sipas dispozitave të Ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin Social", akteve nënligjore në zbatim të tij dhe formulës së pikëzuar të miratuar nga Këshilli Bashkiak, duke vendosur pikët për secilin aplikim.

Neni 8

Detyrat e Komisionit të Strehimit

Sekretariati Administrativ vendos në dispozicion të Komisionit të Strehimit vetëm aplikimet që përmbajnë formularët e seleksionuar si të vlefshëm gjatë Fazës së parë të shqyrtimit dhe dokumentacionin e saktë të kërkuar. Çdo formulari i bashkëlidhet edhe lista e inventarit, i cili përmban të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga aplikuesi dhe i nënshkruar nga punonjësit e autorizuar të Drejtorisë së Emergjencave Civile dhe Strehimit.

Pas marrjes në dorëzim, të listës së inventarit, Komisioni i Strehimit, në bazë të dokumenteve të derguara nga aplikuesi, kryesohet për përzgjedhjen e përfituesve të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës së strehimit social dhe formulës së pikëzuar, shqyrton dhe vlerëson aplikimet dhe vendos pikët për secilin aplikim.

Harton listën përfundimtare të familjeve përfituese, e cila i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak.

Neni 9

Marria e Vendimeve

Komisioni i Strehimit merr vendime vetëm për çështjet të cilat janë në rendin e ditës, përveç rasteve kur të pakten 2/3 e anëtarëve vendosin për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve edhe për çështje të cilat nuk janë në rendin e ditës.

Komisioni merr vendime me shumicë votash. Në raste barazie votash, vota e Kryetarit mbizotëron.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Kryetari i Komisionit voton i fundit. Vendimet e marra në kundërshtim me këtë nen janë të pavlefshme.

Neni 10
Procesverbali i Mbledhjes

Gjate mbledhjes mbahet Procesverbali i mbledhjes nga Sekretari Administrativ. Në procesverbal Sekretari mban shënime për anëtarët e Komisionit të Strehimit që morën pjesë, çështjet që u diskutuan, vendimet që u morën, formën dhe rezultatin e votimit, datën dhe vendin e mbledhjes.

Procesverbali i mbledhjeve nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm dhe nga Sekretari Administrativ.

Procesverbali u paraqet për miratim të gjithë anëtarëve të Komisionit në fund të mbledhjes. Në rastet kur vlerësohet e arsyeshme që mbledhja duhet ndarë në seanca, procesverbali miratohet menjëherë pas përfundimit të seancës përkatëse.

Neni 11
Dispozitat e fundit

Kryetari i Komisionit dhe anëtarët e tij njihen me këtë rregullore dhe sigurojnë të gjitha kushtet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së komisionit.

Neni 12
Sanksione

Mosrespektimi i rregullores së Komisionit të Strehimit përbën shkak për fillimin e procedimit disiplinor për çdo anëtar që shkel këtë rregullore, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi (kur nuk përbën vepër penale).

Mosrespektimi i rregullores së Komisionit të Strehimit përbën shkak për përjashtim për çdo anëtar të komuniteteve të interesuara që shkel rregulloren (kur nuk përbën vepër penale).

Mosnjohja e rregullores, nuk e justifikon nëpunësin apo punonjësin nga përgjegjësia dhe sanksionet e lartpërmendura.